



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 5, datë 13.01.2023

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM, RRUGA "5 PRILL", PALLATI NR.15, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, QË DO TË SISTEMOHEN NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM LALËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 413/1 prot., datë 12.01.2023 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetar i bashkisë, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr.15, Rruga "5 Prill", i dëmtuar

nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që do të sistemohen në zonën e re për zhvillim Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, sipas aneksit nr. 1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 16.01.2023



ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.15, RRUGA "5 PRILL"

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE
1	ARTUR KAJMAKU	4	2+1
2	BUJAR GJYSHI	5	3+1
3	BAJRAM JAKOVA	7	3+1
4	FADIL ALLJASI	5	3+1
5	LIRIJE FILI	1	1+1
6	ROLAND FILI	3	2+1





BASHKIA DURRË
24.01.23 Nr. 342/5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 49/5 prot.

Durrës, më 24.01 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 5 datë 13.01.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative Ishëm, rruga "5 Prill", pallati nr.15, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që do të sistemohen në zonën e re për zhvillim Lalëz, njësia administrative Ishëm”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

